



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167648
Datë: 26.08.2024
Numri i dokumentit: 06085186

KPPP.nr.1214/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Banka për Biznes (BpB), me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, kundër debitorëve 1. Restorant “Atika” Sh.P.K., me adresë rr. “Riza Matoshi” pn, në Ferizaj, me NRB: 811483601 (kredimarrës), 2. Nj.A. me adresë rr. “Saranda 1” në Ferizaj (bashkë-kredimarrës) 3. F.A. me adresë rr. “Saranda 1” në Ferizaj (bashkë-kredimarrës), duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit P.nr.487/23 të datës 13.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 23.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorëve 1. Restorant “Atika” Sh.P.K., me adresë rr. “Riza Matoshi” pn, në Ferizaj, me NRB: 811483601 (kredimarrës), 2. Nj.A. me adresë rr. “Saranda 1” në Ferizaj (bashkë-kredimarrës) 3. F.A. me adresë rr. “Saranda 1” në Ferizaj (bashkë-kredimarrës), SHFUQIZOHET Urdhri P.nr.487/23 i datës 13.07.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, dhe PËRFUNDOHET në tërësi procedura përmbartimore në këtë çështje.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar Urdhrin P.nr.487/23 të datës 13.07.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të Kontratës mbi

Kolateralin-Pengun e luajtshëm K0422/388 të nënshkruar me datë 16.05.2022, dhe Konfirmimit të Regjistrimit të Pengut R-20220517-321, me të cilin ka obliguar të gjitha institucionet financiare (bankat) dhe mikro-financiare të regjistruara në Kosovë që t'i japin të dhënat për xhirollogaritë e debitorëve, të bëjnë bllokimin e xhirollogarive të debitorëve si dhe të bëjnë transferimin e borxhit në vlerë prej 17,497.76 Euro, me kamatë kontraktuese vjetore nga data e parashtrimit të këtij propozimi deri në përmbylljen e borxhit në tërësi, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit deri në pagesën definitive të borxhit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se nga provat e prezantuara nga ana e kreditorit, nuk është vërtetuar fakti që kontrata-marrëveshja për kredinë përmban titull përmbarimor meqë e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore pasi që nuk është lidhur pranë institucionit kompetent, andaj si e tillë nuk është titull përmbarimor. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor si dhe të përfundohet në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se propozimi për përmbarim është inicuar në bazë të kontratës së kredisë dhe kontratës së pengut, ku në mënyrë të qartë janë cekur afatet e përmbushjes së obligimit kreditor, duke theksuar se në mënyrë të qartë janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me ligj për iniciimin e procedurës përmbarimore. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për

Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti përmbartimor K0422/388 e nënshkruar ndërmjet kreditorit dhe debitorit me datë 16.05.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbartimor dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar përmbartimi.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrimit për përmbartim, pasi dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, ndërsa organi përmbartues – Përmbartuesi Privat nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 38, 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1214/23, datë 23.08.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:167648
Datë: 26.08.2024
Numri i dokumentit: 06085186